ANALIZË E GJENDJES ME DIGJITALIZIMIN NË UNIVERSITETET SHTETËRORE NË RMV – DIGIU



FECH
Forum for Educational Change

YEA
YOUTH EMPOWERMENT ASSOCIATION

Institute for Good Governance and Euro Atlantic Perspective

©2023 Forumi për Ndryshime në Arsim (Forum for Educational Change), European Endowment for Democracy (EED)

Publisher:

FECH - Forum for Educational Change
info@fech.mk
www.fech.mk
Ilindenska 87/13-Tetovo

Autor: Blendi Hodai

Redaktor: Biljana Kordalova (IDUEP)

Ekipi hulumtues: Bojan Kordalov (IDUEP), Aleksandar Karatosho (YEA)

Dizajni: Rina Abdullai

Përkthim nga maqedonishtja në shqip: Bardh Zeneli

This publication DigiU has been produced with the support of the European Endowment for Democracy (EED). It's contents do not necessarily reflect the official opinion of EED.

Responsibility for the information and views expressed in this publication lies entirely with the author(s).

Supported by
EUROPEAN ENDOWMENT FOR DEMOCRACY

Tetovë, Prill 2023











PËRMBAJTJA

1 **PARATHËNIE** 4-5

2 **HYRJE** 6-9

- Konfuzioni i theksuar:
  Mënyra tradicionale vs. Mënyra digjitale

3 **METODOLOGJIA** 10-11

4 **GJETJET** 12-21

- Status quo e digjitalizimit të universiteteve shtetërore
- Universiteti „Shën Kirili dhe Metodi“ Shkup
- Universiteti në Tetovë – UT
- Universiteti „Goce Dellçev“ - SHTIP
- Universiteti „Shën Klimenti i Ohrit“ Manastir
- Universiteti “Nënë Tereza”

5 **REKOMANDIME** 22-28

- Rekomandime për përmirësimin e e-shërbimeve
- Rekomandime për përmirësimin e e-learning në universitetet shtetërore

1

PARATHËNIE

Parathënie

Në botën e sotme digjitale që ndryshon me shpejtësi, institucionet e arsimit të lartë janë nën trysni për t'u përshtatur dhe për ta përdorur teknologjinë gjatë praktikave të tyre të shërbimit dhe të të mësuarit. Një gjë e tillë po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme, për arsye se teknologjia vazhdon të luajë një rol kyç në formësimin e shoqërisë sonë dhe të ardhmes së punës. Nisur nga kjo, është imperativ hulumtimi i gjendjes aktuale të shkallës së digjitalizimit të universiteteve shtetërore në Maqedoninë e Veriut, duke vënë theksin në të kuptuarit e pengesave dhe të mundësive lidhur me zbatimin e tij.

Analiza „DigiU" ka për qëllim shqyrtimin e faktorëve që e pengojnë suksesin e transformimit digjital në arsim si dhe të propozojë mënyra për përmirësimin e tij. Nëpërmjet një studimi gjithëpërfshirës të gjendjes aktuale, ky raport do t'i theksojë sfidat dhe mundësitë me të cilat ballafaqohen universitetet shtetërore në Maqedoninë e Veriut në përpjekjet e tyre për ta integruar teknologjinë në proceset e tyre të mësimdhënies.

Ndërsa shikojmë drejt të ardhmes së arsimit, është e qartë se digjitalizimi do të luajë një rol kyç në formësimin e mënyrës se si mësojmë dhe rritemi. Gjetjet nga ky hulumtim do të ofrojnë njohuri të vlefshme për aktorët vendimmarrës, për studentët, për profesorët dhe për palët e interesuara në sektorin e arsimit të lartë, për arsye se këta punojnë në krijimin e një përvoje mësimore më dinamike dhe më tërheqëse për studentët.

Kam nderin ta prezantojë këtë raport dhe shpresoj se gjetjet e të njëjtit do të frymëzojnë përpjekje të vazhdueshme për të shfrytëzuar fuqinë e teknologjisë digjitale në arsim. Së bashku, ne mund të ndihmojmë në ndërtimin e një sistemi të arsimit të lartë më dinamik dhe më inovativ, i pajisur mirë për t'iu përgjigjur sfidave të shekullit XXI dhe më tej. Prandaj, si pjesë e nismës „**DigiU**" jemi të lumtur t'ju informojmë në krijimin e një fronti të përbashkët për digjitalizimin e universiteteve shtetërore së bashku me **Institutin për Qeverisje të Mirë dhe Perspektivë Euroatlantike** dhe me **Youth Empowerment Association - YEA**.

Blend Hodai

Drejtor ekzekutiv i
Forumit për Ndryshime në Arsim



2

HYRJE

- Konfuzioni i theksuar:
  Mënyra tradicionale vs. Mënyra digjitale

Hyrje

Pse digjitalizimi i universiteteve shtetërore? Bojan Kordallov, komunikolog

Arsimi cilësor është prioritet kryesor dhe investim i çdo shoqërie bashkëkohore që synon të krijojë përparim afatgjatë. **Rruga drejt një sistemi arsimor modern kalon nëpërmjet modernizimit të të njëjtit dhe për zbatimin e të cilit, krahas ndjekjes së praktikave më të mira botërore, është i domosdoshëm të investohet tek nxënësit dhe studentët, të investohet vazhdimisht në kuadrin mësimor dhe shkencor, si dhe në të pasurit qasje dhe cilësi të barabartë të procesit arsimor.** Prandaj, futja e mjeteve digjitale në arsim është një temë mjaft serioze e cila vendos për të ardhmen e brezave të sotëm të nxënësve dhe studentëve, por edhe për vendin në tërësi. Përparimi digjital dhe teknologjik po e ndryshon me shpejtësi përditshmërinë tonë si dhe dinamikën në rrjetet sociale dhe marrëdhëniet ekonomike. Andaj, është e domosdoshme që këtë ta orientojmë në drejtim të dëshirueshëm për ne dhe për mbarë shoqërinë.


Ashtu si çdo inovacion arsimor, efektiviteti, rëndësia dhe ndikimi real i tij do të varen nga aftësia e tij për të arritur deri te shoqëria në tërësi. Kjo nënkupton kujdes të vazhdueshëm për tejkalimin e pengesës digjitale, prezantimin e modeleve të reja të të mësuarit, por edhe zhvillimin e aftësive të reja, përmirësimin e shkrim-leximit digjital dhe ridefinimin e përmbajtjeve dhe metodave arsimore. Përveç kësaj, kjo nënkupton edhe qasje në internet dhe në pajisje cilësore, trajnime adekuate për mësuesit, profesorët dhe për të gjithë aktorët tjerë në procesin edukativo-arsimor që do të përfshihen me reforma për modernizimin e arsimit. Me fjalë të tjera, nuk na nevojitet “reformë për hir të reformës”, por reformë në interes të të gjithëve, në interes të arsimit në tërësi dhe të së ardhmes së vendit.

Pandemia e Covid-it dëshmoi se sektori i arsimit të lartë mund të jetë i aftë që shpejt dhe menjëherë t’iu përgjigjet krizave të paparashikueshme dhe kësisoj ta nxjerrë në pah përparësinë dhe ta promovojë transformimin gradual drejt mësimit hibrid në interes të të gjithëve. Në këtë kontekst, arsimi i lartë kaloi nëpërmjet një procesi të vështirë për ngritjen e vetëdijes lidhur me përparësitë që ka digjitalizimi dhe shpresojmë se pjesa më e madhe e bindjeve dhe miteve për proceset digjitale në këtë periudhë disavjeçare tanimë janë tejkaluar.

Ky hulumtim ka për qëllim ta paraqesë progresin dhe pozitën e universiteteve në epokën digjitale, por edhe të ofrojë rekomandime konkrete për atë se si opinioni i përgjithshëm ta kuptojë teknologjinë si mjet që gjeneron një vlerë të shtuar për shoqërinë në tërësi. Digjitalizimi duhet të jetë hapi fillestar në proces, ku institucionet shfrytëzojnë mjete të reja për kryerjen e aktiviteteve të vjetra. Përveç shfrytëzimit të teknologjive të TI, transformimi digjital i institucioneve arsimore, madje edhe i të gjithë sistemit, kërkon ridizajnim të praktikave të të mësuarit dhe të mësimdhënies, rishikim të roleve të të gjitha palëve të përfshira në procesin arsimor dhe promovim të praktikave të reja. Thënë më thjeshtë, **transformimi digjital adekuat do të thotë arsim i përshtatur nevojave të studentëve dhe stafit mësimdhënës ose arsim i përshtatur për këtë shekull 21.**

Jam i bindur se ky punim do të japë kontribut të rëndësishëm drejt progresionit, strukturimit të njohurive dhe të të dhënave, duke theksuar nevojën për aktivitete kërkimore në të ardhmen dhe ndërmarrje të hapave konkretë në pjesën e transformimit digjital të arsimit të lartë.

Konfuzioni i theksuar: Mënyra tradicionale vs. Mënyra digjitale



Universitetet shtetërore në Republikën e Maqedonisë së Veriut po përballen me një konfuzion të theksuar sa i përket shfrytëzimit të shërbimeve tradicionale dhe digjitale. Edhe pse vërehet progres në raport me implementimin e zgjidhjeve digjitale për shërbime të ndryshme administrative, si për shembull regjistrimi online i semestrave, qasja në evidencën akademike dhe sistemet për e-pagesën, këto shërbime zbatohen paralelisht me ato tradicionale. E gjithë kjo shpie në joefikasitet dhe në mungesë të integrimit.

Kjo qasje e fragmentuar mund të çojë në konfuzion dhe frustrim edhe te studentët edhe tek universitetet për arsye se këta detyrohen t'u përshtaten sistemeve dhe proceseve të shumëfishta që ndërmjet vete nuk janë të harmonizuara. Për më tepër, një gjë e tillë mund të shkaktojë vështirësi në ndjekjen dhe monitorimin e informacioneve, gjë që ndikon negativisht në marrjen e vendimeve dhe shpërndarjen e resurseve. Një konfuzion i këtillë thekson nevojën që universitetet në Republikën e Maqedonisë së Veriut t'i japin përparësi digjitalizimit dhe zhvillimit të një strategjie gjithëpërfshirëse që do t'i integronte në tërësi shërbimet tradicionale dhe ato digjitale, duke e zvogëluar kështu joefikasitetin dhe duke e përmirësuar përvojën e përgjithshme studentore dhe të fakultetit.

Nisma „DigiU“ synon ta analizojë gjendjen aktuale sa i takon digjitalizimit të universiteteve shtetërore në R. e Maqedonisë së Veriut, si dhe pengesat dhe mundësitë lidhur me zbatimin e të njëjtit. Ky raport do t'i shqyrtojë faktorët që e pengojnë pranimin e teknologjisë digjitale në arsimin e latë dhe do të propozojë mënyra për përmirësimin e saj. Nisma udhëhiqet nga **Forumi për Ndryshime në Arsim (FNA)** dhe i bashkon organizatat mbështetëse si **Instituti për Qeverisje të Mirë dhe Perspektivë Euroatlantike (IQMPE)** dhe **Asociacioni për Fuqizimin e të Rinjve (AFR)** me qëllim krijimin e një koalicioni më të gjerë në sektorin civil të atyre që angazhohen për digjitalizimin e universiteteve shtetërore.



3

METODOLOGJIA

Metodologjia

Metodologjia e përdorur në këtë analizë kualitative për mungesën e digjitalizimit të universiteteve shtetërore në Maqedoninë e Veriut përfshin kombinimin e intervistave gjysmë të strukturuara dhe analizimin e dokumenteve. Me përfaqësuesit e parlamenteve studentore dhe të rektorateve të pesë universiteteve shtetërore në Maqedoninë e Veriut u realizuan intervista gjysmë të strukturuara. Intervistat u dizajnuan asisoj që të nxjerrin informacione për gjendjen aktuale të digjitalizimit të universiteteve, për sfidat e tyre dhe barrierat e implementimit, si dhe për përfitimet potenciale të digjitalizimit. Krahas kësaj, ky hulumtim gjithëpërfshirës më shumë përqendrohet në ***digjitalizimin e arsimit të lartë nga këndvështrimi studentor.***

Për më tepër, u realizua analizimi i dokumenteve me qëllim mbledhjen e të dhënave nga dokumentet dhe raportet strategjike lidhur me digjitalizimin e universiteteve. Kjo dha informacione për qëndrimin zyrtar dhe qasjen e institucioneve ndaj digjitalizimit si proces.

Të dhënat e mbledhura nga intervistat dhe përpunimi i dokumenteve u analizuan me ndihmën e analizës tematike me qëllim identifikimin e formularëve, të temave dhe të njohurive që kanë të bëjnë me mungesën e digjitalizimit në universitetet shtetërore në Maqedoninë e Veriut.

Ky raport analizon gjendjen aktuale të transformimit digjital të universiteteve shtetërore në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Nëpërmjet këtij raporti, ekipi hulumtues i identifikoi sfidat dhe mundësitë me të cilat ballafaqohen universitetet shtetërore gjatë transformimit digjital.



4

GJETJET

- Status quo e digjitalizimit të universiteteve shtetërore
- Universiteti „Shën Kirili dhe Metodi“ Shkup
- Universiteti në Tetovë – UT
- Universiteti „Goce Dellçev“ - SHTIP
- Universiteti „Shën Klimenti i Ohrit“ Manastir
- Universiteti “Nënë Tereza”

Gjetjet

A kanë universitetet shtetërore në Maqedoninë e Veriut plan për digjitalizimin e shërbimeve dhe të mësimdhënies së tyre me qëllim përmirësimin e cilësisë së studimeve për studentët dhe për anëtarët e tyre të bashkësisë akademike? Përse universitetet shtetërore e përdorin indeksin në letër në shekullin 21?

Status quo e digjitalizimit të universiteteve shtetërore

Gjetjet e këtij hulumtimi tregojnë për një mangësi të theksuar dhe status quo sa i përket digjitalizimit të universiteteve shtetërore. Përkundër rritjes në nivel botëror të përdorimit të teknologjisë në arsim, shumë universitete shtetërore në Maqedoninë e Veriut vazhdojnë të mbështeten në metoda tradicionale të të mësuarit dhe mësimdhënies. Kjo përfshin përdorimin e teksteve mësimore dhe ligjëratave fizike, përdorimin e indeksit në letër (edhe pse ekziston sistemi online i vënies së notave), regjistrimi personal i semestrit dhe konsultimet fizike, në vend që të përdoren resurset online dhe mjetet digjitale.


Përveç kësaj, ky hulumtim dëshmoi se ekziston mungesë e infrastrukturës dhe e resurseve për mbështetjen e digjitalizimit të universiteteve shtetërore. Janë të shumta institucionet të cilëve u mungon teknologjia dhe pajisjet e nevojshme për lehtësimin e mësimit online dhe të shërbimeve online, ndërsa mungon edhe staf i trajnuar profesorësh për mbështetje të implementimit të këtyre teknologjive. Studentët theksuan disa herë se, për t'u bërë universiteti pjesë e epokës digjitale, nevojitet që udhëheqësia të investojë në infrastrukturën digjitale të universiteteve dhe të çdo fakulteti veçmas.

Më tej, hulumtimi tregoi se shumë profesorë universitarë dhe anëtarë të fakulteteve nuk janë të njoftuar me mjetet digjitale (i-learn, Edmodo) dhe nuk i kanë shkathtësitë e duhura për përdorimin efektiv të tyre. Kjo mund të paraqesë barrierë për miratimin e digjitalizimit të universiteteve shtetërore.

Në përgjithësi, gjetjet e hulumtimit tregojnë se ekziston mungesë e theksuar e digjitalizimit të universiteteve shtetërore dhe se nevojiten përpjekje të konsiderueshme për përmirësimin e infrastrukturës, të resurseve dhe për organizimin e trajnimeve të nevojshme për të mbështetur digjitalizimin e këtyre institucioneve.

Bazuar në hulumtimin tonë dhe në përgjigjet e marra me shkrim nga rektoratet e universiteteve shtetërore, përqindja nga buxheti i destinuar për digjitalizimin e universiteteve shtetërore në Maqedoninë e Veriut mbetet relativisht e ulët. Për shembull, Universiteti "Goce Dellçev" ndan vetëm 13% të buxhetit të vet për përpjekjet për digjitalizimit, ndërsa Universiteti "Nënë Tereza" dhe Universiteti "Shën Klimenti i Ohrit" ndajnë 15% dhe 9,56% respektivisht. Universiteti "Shën Kirili dhe Metodij" ndan 11% nga buxheti i tij. Ndarje më të vogël buxhetore ka Universiteti në Tetovë me vetëm 3%.

Kjo flet se ka hapësirë për përmirësim sa i takon investimit në përpjekjet për digjitalizim të universiteteve shtetërore në vend. Buxheti për digjitalizimin e universiteteve shtetërore përfshin licencimin e një softueri përkatës, mbindërtimin e harduerit ekzistues, por edhe përmirësimin dhe zhvillimin e sistemeve digjitale që përdoren nga studentët dhe profesorët.



Universiteti „Shën Kirili dhe Metodi“ Shkup

Përkundër reputacionit si universiteti më i vjetër dhe me rangim më të lartë në vend, Universiteti “Shën Kirili dhe Metodi” nuk ka bërë përpjekje të konsiderueshme për digjitalizim viteve të fundit. Sipas hulumtimit tonë, studentët i identifikuan fushat më kryesore të cilat duhet të digjitalizohen siç janë: paraqitja e provimeve; plotësimi i formularëve; caktimi i takimeve/konsultimeve me profesorët; komunikimi me profesorët; marrja e nënshkrimit dhe e-indeksi. Kjo tregon se ekziston nevoja që universiteti të investojë më shumë resurse dhe përpjekje në digjitalizim, me qëllim që ta përmirësojë efikasitetin dhe prakticitetin e shërbimeve të veta për studentët. Universiteti “Shën Kirili dhe Metodi” përdor dy sistemeve softuerike, **i-know** dhe sistemin **i-learn** për t’i menaxhuar shërbimet e tyre digjitale. Sistemi iKnow përdoret për kryerjen e të gjitha proceseve administrative siç janë vënia e notave, regjistrimi i semestrit, ose me fjalë të tjera, ky sistem paraqet një dosje studentore, ndërsa sistemi i-learn është një platformë digjitale që do t’i lehtësojë procedurat e komunikimit të studentëve dhe stafit mësimor dhe bashkëpunues.

Megjithatë, hulumtimi ynë tregoi se pjesa më e madhe e studentëve nuk janë të informuar për sistemin i-learn dhe se profesorëve u mungojnë njohuritë për ta përdorur, gjë që tregon se ka mungesë të trajnimit dhe të mbështetjes për këta mjete digjitale. Kjo dëshmon se universiteti duhet të investojë në organizimin e trajnimeve dhe të rrisë mbështetjen ndaj sistemeve të veta digjitale me qëllim përmirësimin e efikasitetit dhe përdorimit të tyre.

Senati universitar i UShKM në vitin 2021 miratoi ***vendimin për përcaktimin e konceptit për avancimin e digjitalizimit në Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" Shkup***. Ky dokument ka formuluar një strategji të zhvillimit të sistemeve digjitale për mësimdhënie dhe studentë; për shkencë dhe hulumtim; për menaxhim me burime; dhe për mbështetje harduerike. Pas dy vitesh të tëra, mund të konstatohet se kjo strategji mbeti vetëm në letër, pa u parë zbatimi i saj i pjesshëm. Problem shtesë për digjitalizimin e këtij universiteti paraqet modeli i organizimit që është i decentralizuar përmes njësive të veçanta të fakulteteve, ndërsa procesi i digjitalizimit duhet të jetë prioritet i centralizuar i universitetit.

„Digjitalizimi i universitetit varet nga ajo se sa buxhet do të ndajë universiteti për digjitalizimin e shërbimeve dhe të mësimdhënies". –Prof.Dr. Nikolla Jankullovski

Megjithatë, sipas studentëve të këtij universiteti, një strategji konkrete as që është e nevojshme. Duhet vetëm vullnet nga stafi pedagogjik dhe nga administrata e fakultetit/universitetit si dhe optimizëm se procesi arsimor mund të funksionojë nëpërmjet mjeteve elektronike për mësimdhënie dhe shërbime.

Mjetet digjitale	Për çfarë përdoret + linku
sistem i integruar për shërbime studentore (iKnow)	(vend ku kryhen të gjitha proceset administrative) https://is.iknow.ukim.mk/
e-repozitorium	(vend ku stafi akademik i vendos kërkimet e tij) https://repository.ukim.mk/
i-learn system	(platformë digjitale për komunikim të studentëve dhe të stafit pedagogjik dhe bashkëpunues) https://ilearn.ukim.edu.mk/
e-posta	(adresë elektronike studentore për çdo student)

Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi" Shkup është i përkushtuar të mbetet në krye të inovacioneve digjitale në fushën e arsimit të lartë. Universiteti, në letër ka plane ambicioze për digjitalizimin e aspekteve të ndryshme të veprimtarisë së vet në pesë vitet e ardhshme. Këto plane përfshijnë:

- **Vendosje të platformës digjitale për provime iExam** – kjo do t'u mundësonte studentëve t'iu nënshtrohen provimeve në çdo vend dhe në çdo kohë, duke e pakësuar nevojën që studentët të jenë fizikisht të pranishëm në kampus.
- **Vendosje të portalit Qendra e karrierës** – kjo do t'u mundësonte studentëve qasje të lehtë deri te resurset dhe informacionet që kanë të bëjnë me karrierat e tyre të ardhshme, përfshi edhe me mundësitë për punësim, praktikë dhe evente për rrjetëzim. **Regjistër digjital i menaxhimit me e-formën e punimeve të diplomës, të magjistraturës dhe të doktoraturës**
- **Sistem i anketimit elektronik dhe i vlerësimit** – ky sistem do t'u lehtësojë studentëve procesin e vlerësimit të profesorëve të tyre dhe të universitetit në tërësi, duke ndihmuar kështu përmirësimin e vazhdueshëm të universitetit.

Në rast se këto plane ambicioze të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” Shkup do të implementohen plotësisht në pesë vitet e ardhshme, atëherë universiteti në fjalë do të bëhet një nga universitetet më të digjitalizuara në vend.

Universiteti në Tetovë – UT

Edhe pse Universiteti në Tetovë – UT ka arritur rezultate premtuese në transformimin digjital, kufizimi i investimeve në digjitalizim është paraqitur me përfaqësim të ulët në buxhet (vetëm 3%). E gjithë kjo dëshmon se ekziston mungesë e përkushtimit nga udhëheqësia dhe (mos)dhënie përparësi digjitalizimit si proces i rëndësishëm për zhvillimin e Universitetit.

Është arritur progres i rëndësishëm në fushën e e-shërbimeve me miratimin e ***Learning Management System (LMS)*** për regjistrim dhe pagesë elektronike të semestrit, indeks elektronik, paraqitje të lëndëve etj. Ky është një hap në drejtimin e duhur. Megjithatë, Universiteti, ashtu si universitetet e tjera shtetërore, punon paralelisht me procese tradicionale dhe digjitale, gjë që rezulton dhe shpie në joefikasitet dhe në mungesë të proceseve digjitale plotësisht të integruara dhe shkakton frustrim te studentët.

Për më tepër, kjo qasje e fragmentuar ndaj digjitalizimit mund të rezultojë edhe me mungesë të integrimit ndërmjet sistemeve dhe proceseve të ndryshme, gjë që çon në një mungesë të koherencës në strategjinë e përgjithshme digjitale. Kjo e vështirëson realizimin e të gjithë potencialit të digjitalizimit dhe realizimin e plotë të përfitimeve në kuptimin e përmirësimit të efikasitetit, të qasjes dhe të rezultateve të studentëve. Prandaj, është tejet e rëndësishme që Universiteti në Tetovë të investojë më shumë resurseve në digjitalizim dhe të zhvillojë një strategji gjithëpërfshirëse për t’u ballafaquar me këto sfida dhe për t’i tejkaluar pengesat për digjitalizim.


Mjetet digjitale	Për çfarë përdoret + linku
sistem i integruar për shërbime studentore LMS i-know system)	(vend ku kryhen të gjitha proceset administrative) https://lms.unite.edu.mk/Identity/Account/Login
e-repozitorium (RMS system)	(vend ku stafi akademik i vendos kërkimet e tij) https://eservices.unite.edu.mk/rms/
e-posta	(adresë elektronike studentore për çdo student)
e-mësim	Gjatë kohës së pandemisë, UT përdorte “Classroom” dhe “Zoom”

Universiteti i Tetovës ka plane ambicioze për pesë vitet e ardhshme për ta përmirësuar infrastrukturën dhe shërbimet e saj digjitale për studentët. Një nga prioritetet kryesore është vendosja e diplomave digjitale, që do t'u mundësonte studentëve një version të sigurt dhe lehtësisht të qasshëm të diplomës së tyre, duke e zvogëluar kështu nevojën për kopje të letrave dhe duke ua lehtësuar studentëve ndarjen e kredencialeve të tyre me punëdhënësit dhe me institucionet e tjera.

Universiteti i Tetovës planifikon të implementojë sistemin e evidencës elektronike me ndihmën e kartelave studentore, gjë e cila do të bëjë të mundur një mënyrë të sigurt dhe efikase që studentët të qasen dhe të menaxhojnë me evidencën e tyre akademike. Ky sistem do t'i përfshijë notat, procesverbalet dhe informacionet e tjera të rëndësishme, duke ua lehtësuar studentëve ndjekjen e progresit të tyre dhe planifikimin e udhëtimit të tyre akademik.

Me qëllim përmirësimin shtesë të përvojës studentore, Universiteti i Tetovës planifikon gjithashtu zgjerimin e rrjetit të tij të WiFi-së për ta mbuluar të gjithë kampusin, që studentëve t'u sigurohet qasje e sigurt dhe e shpejtë në internet. Kjo do t'u mundësonte studentëve t'i shfrytëzojnë përparësitë e mjeteve dhe resurseve digjitale, siç janë ligjëratat online dhe materialet studimore interaktive si dhe të marrin pjesë në mundësitë për të mësuar nga distanca.

Nismat e këtilla shprehin përkushtimin e Universitetit të Tetovës për t'u siguruar studentëve resurse dhe përkrahjen e nevojshme për të pasur sukses në karrierën e tyre akademike dhe profesionale dhe do ta pozicionoin universitetin si lider në arsimin e lartë digjital, por vetëm në rast se e zbatojnë strategjinë e paraparë.



Universiteti „Goce Dellçev“ - SHTIP

Universiteti „Goce Dellçev“ – Shtip është gjerësisht i pranuar si një nga universitetet shtetërore teknologjikisht më të avancuar dhe të transformuar në aspektin digjital në Maqedoninë e Veriut. Ky universitet njihet për nga qasja e vet bashkëkohore ndaj arsimit të lartë me zhvillimin e platformave për **e-indeks, e-mësim, e-repozitorium, e-bibliotekë, e-kalendar, e-orar**, ndërsa gjatë periudhës së pandemisë, me qëllim realizimin e mësimit online, u përdor edhe platforma e Microsoft Teams.

„Pandemia dëshmoi se të investuarit në TI dhe digjitalizimi është pjesë e patjetërsueshme e arsimit të lartë“. –Prof. Dr. Dejan Mirakovski

Mjetet digjitale	Për çfarë përdoret + linku
e-indeks	(vend ku kryhen të gjitha proceset administrative) https://students.ugd.edu.mk/
e-bibliotekë	(vend ku gjenden të gjitha materialet në formë elektronike dhe ku studentët mund t’i shkarkojnë falas) https://e-lib.ugd.edu.mk/naslovna.php
e-postë	(adresë elektronike studentore për çdo student)
e-orar	(orari i aktiviteteve gjatë semestrit) https://www.ugd.edu.mk/index.php/studenti/e-ugd/e-raspored
e-repozitorium	(vend ku stafi akademik i vendos kërkimet e tij) http://eprints.ugd.edu.mk/
e-mësim	Platforma Moodle për mësimdhënie dhe dhënie të provimeve, ku profesorët i organizojnë ligjëratat e tyre) https://lipovdol-fs.ugd.edu.mk/adfs
e-kalendar	(kalendari akademik i aktiviteteve) https://www.ugd.edu.mk/images/e_index/kalendar-vodic-prv-ciklus.pdf
e-pagesë	qasje për pagesë online për regjistrim dhe verifikim të semestrit, si dhe për paraqitjen e provimeve

Përkundër reputacionit të tij si një ndër universitetet shtetërore teknologjikisht më të avancuar në Maqedoninë e Veriut, dhënia e notave në Universitetin “Goce Dellçev” – Shtip akoma realizohet nëpërmjet **indeksëve në letër dhe elektronikë,** që jo vetëm se është joefikase, por edhe merr shumë kohë edhe për studentët edhe për profesorët. Për më tepër, Universiteti nuk ka të miratuar strategji për digjitalizim. Aktivitetet dhe planet konkrete për digjitalizim të Universitetit janë pjesë e Planit të punës së rektorit. Universiteti “Goce Dellçev” ka plane ambicioze për digjitalizim në pesë vitet e ardhshme. Fokusi është në zhvillimin e nje aplikacioni mobil gjithëpërfshirës dhe të integruar për studentët. Ky aplikacion do të përfshirë e-indeksin, kalendarin dhe informacionet mbi programet studimore.

Kjo do t'ua lehtësonte studentëve të mbeten të informuar dhe t'i ndjekin studimet e tyre. Krahas kësaj, Universiteti planifikon të implementojë sistem të nënshkrimit digjital që studentët të mund të kenë qasje në dokumentet që u nevojiten, pa qenë të detyruar të shkojnë fizikisht në Universitet për t'i marrë.

Universiteti „Shën Klimenti i Ohrit“ Manastir

Universiteti „Shën Klimenti i Ohrit“ Manastir ka filluar të ketë disa përmirësime në digjitalizimin e shërbimeve, por procesi është shumë i ngadalshëm. UShKO e përdorën e-indeksin dhe t gjitha notat vendosen aty, megjithatë është e detyrueshme që nota të shënohet edhe në indeksin në letër, që për të gjithë studentët paraqet një problem të madh për arsye se duhet të kërkohen profesorët në dhe jashtë termineve kur janë në vendin e punës me qëllim marrjen e notave dhe të nënshkrimeve për provimet që i kanë dhënë. Kjo merr shumë kohë dhe nuk është efikase. Përveç kësaj, procesi i regjistrimit dhe pagesa e semestrit zhvillohet fizikisht, në një kohë kur të gjitha shërbimet duhet të kryhen online, pa pritje.

Për digjitalizimin e mësimdhënies, Universiteti përdor Google Classroom (komunikim, materiale për të mësuar) dhe Microsoft Teams (zhvillim online i mësimdhënies).

Mjetet digjitale	Për çfarë përdoret + linku
e-indeks	(vend ku kryhen të gjitha proceset administrative) https://iknow.uklo.edu.mk/
e-mësim	Moodle, Google classroom, MS Teams
e-repozitorium	https://eprints.uklo.edu.mk/
e-postë	(adresë elektronike studentore për çdo student)

Planet për digjitalizim të mësimdhënies dhe të shërbimeve të Universitetit “Shën Klimenti i Ohrit” janë pjesë e Programit të punës dhe zhvillimit të Universitetit. Programi përqendrohet në sistemin për e-mësim, përmirësimin e sistemit iknow, përmirësimin e ueb faqeve dhe në punën e *cloud*.

Universiteti “Shën Klimenti i Ohrit” Manastir ka plane ambicioze për pesë vitet e ardhshme sa i takon digjitalizimit. Synimi kryesor i tij është të krijojë një sistem qendror të digjitalizuar që do t'i integronte të gjitha shërbimet që i ofron universiteti. Kjo do të arrihet me implementimin e “sistemit cloud të shërbimeve” për studentët dhe profesorët, me sigurimin e internetit cilësor dhe të shpejtë të kampusit universitar dhe me zhvillimin e një ekosistemi digjital gjithëpërfshirës për Universitetin. Në anën tjetër, të ofruarit e internetit cilësor dhe të shpejtë është kyç për t'u siguruar që studentët dhe profesorët të kenë akses në shërbimet digjitale që i ofron Universiteti në kohë dhe në mënyrë të sigurt. Duke investuar në infrastrukturë të internetit cilësor dhe të shpejtë, Universiteti bën hapin e parë drejt transformimit digjital të Universitetit.

Së fundi, zhvillimi i një ekosistemi digjital gjithëpërfshirës për Universitetin do të sigurojë që të gjitha shërbimet janë të integruar dhe të racionalizuar, që do të rezultojë me rritje të efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënies. Kjo do t'i mundësojë Universitetit të masë dhe vlerësojë më mirë performancën e vet dhe të marrë vendime për përmirësim të vazhdueshëm në bazë të të dhënave.

Universiteti "Nënë Tereza"






Në bazë të hulumtimit tonë, Universiteti "Nënë Tereza" ka njohuri të kufizuara për atë se çfarë në të vërtetë nënkupton digjitalizimi i arsimit të lartë dhe si mund kjo të zbatohet që t'i përmirësojë shërbimet dhe mësimdhënien e vet. Universiteti "Nënë Tereza" është themeluar si universitet shtetëror në vitin 2016 dhe deri tani mbetet prapa sa i takon implementimit të zgjidhjeve inovative dhe efektive për transformim digjital të universitetit.

Është e një rëndësie thelbësore që Universiteti "Nënë Tereza" të investojë në të kuptuarit dhe zbatimin e digjitalizimit, pasi kjo gjë është faktor kyç për të mbetur konkurrues me institucionet e tjera të arsimit të lartë. Duke miratuar një strategji gjithëpërfshirëse digjitale dhe një plan veprimi për ta implementuar atë, Universiteti mund t'i përmirësojë shërbimet e tij, të rrisë efikasitetin dhe të përmirësojë përvojën e të mësuarit për studentët.

Mungesa e platformës digjitale siç është LMS ose sistemi i-know në Universitetin "Nënë Tereza" shkakton probleme të shumta për studentët. E para, studentët nuk mund t'i kontrollojnë notat e tyre online dhe duhet të shërbehen me metodat tradicionale, siç janë konsultimet fizike dhe vënia e notave vetëm në indeksin në letër. Kjo mund të marrë shumë kohë dhe të jetë e papërshtatshme, veçanërisht për studentët që jetojnë larg Universitetit ose që kanë orar të ngjeshur.

Për më tepër, mungesa e një sistemi regjistrimi online do të thotë që studentët nuk mund t'i regjistrojnë semestrat ose të kenë akses në shërbime të tjera administrative pa qenë fizikisht në fakultet. Gjithashtu, mungesa e një platforme digjitale krijon probleme edhe në administratën e Universitetit, si dhe shkakton funksionimin joefikas të administratës së Universitetit. Kjo çon në pritje më të gjata dhe në vëllim më të madh të punës për punonjësit e administratës, gjë që mund të ndikojë në cilësinë e shërbimit që ua ofrojnë studentëve. Si përfundim, mungesa e një platforme digjitale në Universitetin "Nënë Tereza" krijon sfida të rëndësishme për studentët, të cilët nuk janë në gjendje të kenë qasje në mënyrë efikase në shërbimet që u nevojiten. Kjo mund të ndikojë në përvojën e tyre të përgjithshme universitare.

Universiteti "Nënë Tereza" i ka vendosur vetes si synim digjitalizimin e plotë të të gjitha shërbimeve administrative për studentët në tre vitet e ardhshme. Ky plan ambicioz synon t'i racionalizojë dhe t'i thjeshtëzojë proceset nëpër të cilat duhet të kalojnë studentët, siç janë regjistrimi dhe pagesa për semestrat dhe aksesi elektronik në notat dhe në informacione të tjera të rëndësishme. Duke i digjitalizuar këto shërbime, Universiteti synon ta përmirësojë përvojën e përgjithshme për studentët, duke e bërë më të lehtë dhe më efikas për ta qasjen në resurset që u nevojiten. Megjithatë, suksesi i këtij plani do të varet nga disa faktorë, duke përfshirë të kuptuarit nga ana e Universitetit se çfarë do të thotë digjitalizimi dhe aftësitë teknike të Universitetit për ta zbatuar atë. Kështu, prioritet i Universitetit "Nënë Tereza" është të bëjë një analizë gjithëpërfshirëse të nevojave digjitale të Universitetit. Kjo mund të përfshijë investimin në teknologjinë dhe infrastrukturën e nevojshme dhe ofrimin e trajnimit dhe mbështetjes për fakultetin dhe administratën. Për më tepër, është e nevojshme përfshirja e palëve të interesuara, siç janë studentët, për të mbledhur *feedback* dhe për të siguruar që plani i digjitalizimit të përputhet plotësisht me nevojat dhe pritshmëritë e atyre që do të përdorin shërbimet e reja digjitale.



5

REKOMANDIME

- Rekomandime për përmirësimin e e-shërbimeve
- Rekomandime për përmirësimin e e-learning në universitetet shtetërore

Rekomandime

Perceptimet e studentëve për universitetet e digjitalizuara janë më pak vizionare, por mjaft pragmatike. Dy kategori dominojnë qartë dëshirat e studentëve për transformimin digjital të institucioneve të arsimit të lartë:

1. **E-services** – do të thotë digjitalizim i proceseve administrative siç janë regjistrimi i semestrave, e-pagesa dhe përdorimi vetëm i indekseve elektronike për notat. Këto janë thelbësore për përmirësimin e efikasitetit dhe lehtësimin e detyrimeve të çdo studenti. Nëpërmjet e-shërbimeve, studentët mund të kursejnë kohë dhe përpjekje në menaxhimin e çështjeve të tyre akademike dhe mund t'i shmangin radhët e gjata dhe kohën e pritjes në Universitet.
2. **E-learning** – si një mënyrë për ta përmirësuar përvojën e përgjithshme të të mësuarit, me ç'rast përdorimi i mjeteve digjitale si leksionet online dhe materialet interaktive të studimit është shumë i dëshirueshëm. Me e-learning, studentët mund të kenë akses në resurse të ndryshme arsimore nga kudo dhe në çdo kohë. Kjo u mundëson studentëve më shumë fleksibilitet në të mësuarit e tyre dhe mund të jetë veçanërisht i dobishëm për studentët që mund të kenë angazhime të tjera, të tilla si angazhimet në punë ose në familje.

Në përgjithësi, studentët presin që universiteti të ofrojë zgjidhje praktike dhe të përshtatshme për ta bërë përvojën e tyre universitare më efikase. Duke u ballafaquar me këto nevoja, universitetet mund t'i përmbushin më mirë pritshmëritë e studentëve të tyre dhe ta përmirësojnë përvojën e tyre të përgjithshme universitare.

REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIMIN E E-SHËRBIMEVE TË UNIVERSITETEVE SHTETËRORE

1. *Vendosja e sistemit 0 papirologji duke përshtatur sistemin i-know për regjistrimin digjital, verifikimin semestral dhe aplikimet*

Përmirësimi i sistemit aktual i-know, në mënyrë të ndjeshme do ta përmirësojë efikasitetin dhe aksesin e studentëve për të kryer të gjitha proceset administrative online. Ky sistem duhet t'i përfshijë të gjitha informacionet dhe shërbimet e nevojshme që studentët të menaxhojnë me përvojën e tyre universitare online. Zhvillimi i një sistemi efikas dhe të lehtë për përdorim do të përmirësojë ndjeshëm efikasitetin dhe aksesin e proceseve të regjistrimit për studentët. Ky sistem duhet të përshtatet në mënyrë që t'i përfshijë të gjitha informacionet dhe shërbimet e domosdoshme, të nevojshme që studentët ta menaxhojnë përvojën e tyre studentore në mënyrë digjitale, pa qenë nevoja që kjo të shkojë paralelisht me mënyrën tradicionale. Prandaj, universitetet duhet t'i kenë parasysh masat e mëposhtme për të përmirësuar sistemin i-know:

- Të bëhet një vlerësim gjithëpërfshirës i nevojave që të identifikohen fushat specifike të përmirësimit për sistemin i-know.
- Të mblidhen informacione kthyese nga studentët dhe punonjësit mbi përdorshmërinë e sistemit të përmirësuar i-know. Këto informacione kthyese do të përdoren për përmirësime dhe përditësime të ardhshme të sistemit.
- Të sigurohet që sistemi i përmirësuar i i-know mirëmbahet dhe përditësohet rregullisht për të siguruar efektivitetin dhe përdorshmërinë e tij të vazhdueshme.

2. Funksionalizimi i e-indeksit dhe asgjësimi i indeksit në letër:

Zbatimi i një programi pilot në fakultetet më të vogla do të sigurojë njohuri të vlefshme për përfitimet dhe sfidat e mundshme nga zbatimi i indeksit elektronik plotësisht funksional. Bazuar në këto njohuri, duhet të zhvillohet një kornizë për shënimin e notave në e-indeks dhe të shtrihet në të gjitha fakultetet.

Përveç programit pilot, duhet të ndërmerren masat e mëposhtme konkrete që të sigurohet zbatimi i suksesshëm i e-indeksit:

- **Testimi dhe komentet nga përdoruesit**: Përfaqësuesit e studentëve duhet të përfshihen në procesin e zhvillimit, duke dhënë komente dhe propozime se si të bëhet e-indeksi sa më user-friendly për studentët.
- **Kompatibil me telefonat celularë**: Zhvillimi i e-indeksit në një aplikacion celular që është i përshtatshëm për përdoruesit dhe që u lejon studentëve qasje në të nga pajisjet e tyre celulare.
- **Privatësia dhe siguria e të dhënave**: e-indeksi duhet të jetë në përputhje me të gjitha rregullat përkatëse të privatësisë dhe sigurisë së të dhënave. Kjo përfshin masat për mbrojtjen e të dhënave personale dhe akademike të studentëve.
- **Sistemet e integruara**: E-indeksi duhet të integrohet me sisteme të tjera që i përdor universiteti, siç është sistemi i-know/LMS, që të sigurohen procese të papenguara dhe efikase.
- **Trajnime dhe mbështetje të vazhdueshme**: Universiteti duhet të ofrojë trajnime dhe mbështetje për studentët, profesorët dhe stafin për atë se si ta përdorin e-indeksin, si dhe azhurnime dhe mirëmbajtje të rregullta për t'u siguruar që ai të mbetet funksional dhe i përditësuar.
- **Monitorimi dhe vlerësimi**: Implementimi dhe funksionalizimi i e-indeksit duhet të monitorohet dhe vlerësohet rregullisht për t'u vlerësuar efikasiteti i tij dhe të bëhen përmirësimet e nevojshme. Kjo duhet të bëhet përmes komenteve të studentëve, anketave të fakultetit dhe analizës së të dhënave.

Këto masa do të ndihmojnë në sigurimin e implementimit dhe funksionalizimit të e-indeksit, duke u ofruar studentëve një mënyrë efikase dhe të aksesueshme për menaxhim me informacionet dhe progresin e tyre akademik.

3. Shndërrimi çështjeve studentore në një shërbim për mbështetje të studentëve:

Për të ofruar shërbime më të mira për studentët, departamenti i çështjeve studentore duhet të shndërrohet nga një shërbim administrativ në një shërbim mbështetës. Kjo do t'i lejojë ata të përqendrohen dhe t'u japin studentëve udhëzimet, ndihmën dhe informacionet e nevojshme për t'ua lehtësuar studimet e tyre.

Për zbatimin me sukses të këtij rekomandimi, universiteteve ua propozojmë masat vijuese:

- Organizim i trajnimeve për stafin dhe zhvillim i mundësive për përmirësimin e njohurive dhe aftësive të tyre në ofrimin e mbështetjes për studentët.
- Zbatim i mekanizmave efektivë për marrjen e komenteve nga studentët me qëllim që të kontribuojnë në mënyrë aktive me propozime për përmirësimin e mbështetjes së ofruar nga shërbimi për çështjet e studentëve.
- Vlerësim i rregullt dhe përmirësim i shërbimeve bazuar në komentet e dhëna nga studentët.
- Promovim i komunikimit të hapur ndërmjet shërbimit të çështjeve studentore, departamenteve akademike dhe studentëve për të siguruar që të gjitha palët e interesuara po punojnë në drejtim të studentëve dhe të lehtësimit të studimeve të tyre.
- Rritje e pagave nëpërmjet futjes së key-performance indicator.

4. Përditësimi i mjeteve dhe platformave digjitale:

Për t'u ofruar studentëve shërbimet më të mira të mundshme dhe për t'u siguruar që universitetet të mbeten në radhët e para të inovacionit teknologjik, është tejet e rëndësishme që platformat si i-know, i-learn dhe e-biblioteka të përditësohen dhe përmirësohen rregullisht . Kështu, universitetet duhet t'i ndërmarrin masat e mëposhtme:

- Krijimi i një ekipi të përkushtuar të TI-së përgjegjës për mirëmbajtjen dhe përditësimin e platformave i-know, LMS, i-learn dhe e-bibliotekës. Ky ekip duhet të përfshijë specialistë të TI-së dhe ekspertë për përvojën e përdoruesit.
- Kryerja e vlerësimeve të rregullta të platformës për t'u identifikuar fushat për përmirësim dhe për t'u dhënë përparësi azhurnimeve (përditësimeve) bazuar në nevojat dhe komentet e studentëve dhe të fakultetit.
- Zbatimi i një mekanizmi për komente dhe propozime nga studentët dhe profesorët për të siguruar informacione rreth platformave dhe për të propozuar përmirësime.
- Vendosja e një orari për përditësimet e rregullta të platformës, me qëllime të qarta dhe me afat kohor.
- Promovimi i bashkëpunimit me universitete dhe organizata të tjera për të ndarë praktikat dhe resurset e mira për azhurnimin dhe avancimin e platformave.

5. Bashkëpunim më i madh dhe më i rregullt me profesorët:

Bashkëpunimi më i madh dhe më i rregullt me profesorët do të ndihmojë që e-shërbimet e universiteteve shtetërore të jenë në përputhje me nevojat e studentëve, stafit akademik dhe universitetit në tërësi. Kjo do të ndihmojë për të siguruar që e-shërbimet janë të përshtatura për të përmbushur nevojat e komunitetit universitar dhe se ato janë efektive dhe të qëndrueshme në afat të gjatë.

- Konsultime të rregullta me profesorët dhe komunitetin akademik për të shkëmbyer ide dhe rekomandime për përmirësimin e sistemit të e-shërbimeve.

REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIMIN E E-LEARNING NË UNIVERSITETET SHTETËRORE

1. Internet cilësor dhe i shpejtë për çdo student/e:

Sigurimi i rrjetit të internetit funksional dhe të sigurt në të gjitha kampuset universitare shtetërore për të mbështetur sistemin i-learning dhe për të garantuar akses të papenguar në burimet online. Për t'u zbatuar ky rekomandim, universitetet duhet të marrin masat e mëposhtme:

- Të bëhet një vlerësim gjithëpërfshirës i infrastrukturës aktuale të internetit në të gjitha kampuset për identifikimin e të gjitha zbrazëtirave ose dobësive.
- Të zhvillohet një plan për ta përmirësuar dhe zgjeruar mbulimin e rrjetit për të mundësuar që të gjitha kampuset universitare të kenë një lidhje të sigurt në internet.
- Të bashkëpunohet me ofruesit e shërbimeve të internetit për të negociuar kushte më të mira dhe për të përmirësuar infrastrukturën e rrjetit sipas nevojës.
- Të monitorohet rregullisht performanca e rrjetit për të siguruar që ai funksionon në mënyrë optimale dhe se po plotësohen nevojat e komunitetit universitar.
- Të lidhet marrëveshje për shërbime me ofruesit e shërbimeve të internetit për t'u siguruar që të gjitha problemet e rrjetit do të zgjidhen në kohë
- Të zbatohen masat e sigurisë së rrjetit, siç janë muret mbrojtëse, për t'u mbrojtur nga sulmet kibernetike dhe aksesi i paautorizuar në të dhëna të ndjeshme.

2. Studentët kërkojnë mësimdhënie fleksibël dhe të kombinuar:

Vendosja e një sistemi hibrid për të mësuar përmes platformës i-learn që t'u mundësohet studentëve mësim fleksibël me kombinim të metodave online dhe atyre tradicionale të mësimdhënies duke shtuar ligjërata në platformën i-learn. Për t'u vendosur një sistem hibrid për të mësuar përmes platformës i-learn dhe për t'iu mundësuar studentëve mësim fleksibël që kombinon metodat e mësimdhënies online dhe tradicionale të bazuara në klasë, mund të ndërmerren masat e vijuese:

- Sigurimi i pajisjeve dhe teknologjisë së nevojshme për profesorët për incizimin dhe ngarkimin e leksioneve të tyre në platformën i-learn.
- Trajnime aktive me kuadrin mësimdhënës lidhur me vendosjen e i-learn. Pas përfundimit të trajnimeve, kontrolli dhe vlerësimi se kush sa përdor.
- Krijimi i udhëzimeve dhe praktikave më të mira për incizimin dhe ngarkimin e leksioneve në platformën i-learn.
- Të sigurohet që platforma i-learn të ketë kapacitet të mjaftueshëm për t'i pranuar të gjitha ligjëratat dhe të jetë e aksesueshme për të gjithë studentët.
- Të siguruarit e komenteve për profesorët lidhur me përdorimin e platformës i-learn për të azhurnuar modifikimet e nevojshme për përmirësimin e platformës.
- Monitorimi i suksesit dhe ndikimit të sistemit hibrid të të mësuarit dhe përshtatja sipas nevojës për t'u siguruar që ato janë "up to date".

3. Rritja e numrit të punonjësve në sektorin e TI-së dhe ofrimi i pagave konkurruese për të tërhequr dhe mbajtur profesionistë të kualifikuar të cilët mund t'i mbështesin dhe mirëmbajnë sistemet digjitale.

- Bashkëpunimi më i madh me universitete dhe institucione të tjera për të shkëmbyer praktikat dhe njohuritë më të mira për tërheqjen dhe mbajtjen e profesionistëve të TI-së në fushën e arsimit digjital nëpërmjet krijimit të një qendre digjitale me universitetet shtetërore.
- Vlerësimi i stafit të TI-së në të gjitha universitetet/fakultetet për të identifikuar fushat ku nevojiten resurset shtesë.
- Sigurimi i mbështetjes financiare dhe i stimulimit për të rinjtë dhe angazhimi i profesionistëve të rinj të TI-së nga universitetet me qëllim transformim e qëndrueshëm digjital në arsimin e lartë dhe mbrojtjen kundër sulmeve kibernetike dhe sulmeve të tjera hibride.
- Bashkëpunimi me fakultetet e TI-së dhe angazhimi i studentëve nga këto fakultete për mirëmbajtjen e sistemeve për ata që kanë staf të mjaftueshëm kompetent.
- Zhvillimi i strategjive të mbajtjes (retention strategies) të tilla si aranzhimet fleksibël të punës, për të mbështetur nevojat profesionale dhe personale të punonjësve të TI-së.

4. Studentët kërkojnë e-bibliotekë për të pasur qasje në literatura të ndryshme

Vendosja e e-bibliotekës në Universitetin "Shën Kirili dhe Metodij", në Universitetin "Shën Klimenti i Ohrit " dhe në Universitetin e Tetovës për t'u ofruar studentëve qasje të lehtë në një gamë të gjerë të materialeve edukative, duke përfshirë revista akademike, tekste universitare dhe burime multimediale. Kjo do të mbështesë mësimin e studentëve dhe do ta përmirësojë përvojën e përgjithshme të universiteteve shtetërore. Për ta realizuar me sukses këtë, universitetet duhet t'i ndërmarrin masat vijuese:

- Krijimi i një e-biblioteke duke shkëmbyer praktikat e mira me Universitetin "Goce Dellçev", pasi ata kanë e-bibliotekë prej disa vitesh.

- Digjitalizimi i materialeve ekzistuese të shtypura në bibliotekën universitare, duke përfshirë libra, revista dhe burime të tjera, për t'i vënë ato në dispozicion në format elektronik.
- Zhvillimi i politikave për shfrytëzimin e e-bibliotekës, duke përfshirë rregullat për aksesin dhe huazimin e materialeve, si dhe udhëzime për përdorimin e drejtë të burimeve digjitale.
- Të mundësohet që e-biblioteka të azhurnohet rregullisht me materiale dhe burime të reja për t'u siguruar që ajo të mbetet një resurs i vlefshëm për studentët dhe profesorët.
- Vlerësimi i vazhdueshëm i suksesit të e-bibliotekës në baza të vazhdueshme duke përdorur metrikë siç janë statistikat e përdorimit dhe reagimet e përdoruesve me qëllim që të identifikohen fushat për përmirësim dhe për të siguruar që e-biblioteka i plotëson nevojat e komunitetit universitar.



www.fech.mk